



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.81

4 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 421, datë 28.4.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikë së Shqipërisë	3555
Vendim i KM nr.425, datë 4.5.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	3555
Vendim i KM nr.426, datë 22.4.2009	Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të dërguar me misione ushtarake jashtë vendit..	3556
Vendim i KM nr.427, datë 27.4.2009	Për një shtesë në vendimin nr.1, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, të ndryshuar	3557
Vendim i KM nr.430, datë 22.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e përfaqësisë së përhershme të Republikës së Shqipërisë, pranë selisë së NATO-s, Bruksel”, të ndryshuar	3558
Vendim i KM nr.431, datë 27.4.2009	Për një shtesë në vendimin nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”	3559
Vendim i KM nr.546, datë 28.5.2009	Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e portit të Durrësit	3559
Udhëzim i MB nr.274, datë 5.5.2009	Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve	3560

Udhëzim i MF nr.27, datë 27.4.2009	Për përcaktimin e rregullave dhe mënyrës së pagesës së kompensimit të çmimit të letërnjoftimit për shtresat në nevojë	3561
Udhëzim i MI nr. 1, datë 14.5.2009	Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European në shqip dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët zyrtare të BE-së	3570
Udhëzim i MI nr.2, datë 14.5.2009	Për funksionimin e komisionit të posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyer të legjislacionit të Bashkimit European në shqip	3572
Vendim i GJK nr.13, datë 4.5.2009	Me objekt shfuqizimin e nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 6.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë	3574
Vendim i KKRT nr.820, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Fraholli”	3577
Vendim i KKRT nr.821, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Flavio Cable”	3577
Vendim i KKRT nr.822, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Maqallara”	3578
Vendim i KKRT nr.823, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Tërbuf”	3578
Vendim i KKRT nr.824, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Dushk”	3579
Vendim i KKRT nr.825, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Futura-Com”	3579
Vendim i KKRT nr.827, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “K 8”	3580
Vendim i KKRT nr.828, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Luna”	3580
Vendim i KKRT nr.829, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Jug”..	3581
Vendim i KKRT nr.830, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Portëz”	3581
Vendim i KKRT nr.831, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Pojan”	3582
Vendim i KKRT nr.832, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Roskovec”	3582

Vendim i KKRT nr.833, datë 24.4.2009	Për ndryshimin e zonës së licencimit për televizionin kabllor privat “TV Delta”	3583
Vendim i KKRT nr.834, datë 24.4.2009	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Hudenisht”	3583
Vendim i KKRT nr.836, datë 24.4.2009	Për zgjerim zone licencimi për televizionin privat kabllor “Inkusat”	3584
Vendim i KKRT nr.838, datë 24.4.2009	Për dhënie licence Për televizionin kabllor privat “TV Tata Junior”	3584
Vendim i KKRT nr.840, datë 24.4.2009	Për zgjerimin e zonës së licencimit të operatorit televiziv privat kabllor “TV Star”	3585
Vendim i KKRT nr.841, datë 24.4.2009	Për zgjerimin e zonës së licencimit të operatorit televiziv privat kabllor “TV Bilishti”	3585
Vendim i KKRT nr.843, datë 24.4.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Magic”	3586
Vendim i KKRT nr.844, datë 24.4.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat kombëtar “Radio +2”	3586
Vendim i KKRT nr.846, datë 24.4.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Logos”	3587
Kërkesë e MPPTT nr.3070, datë 6.5.2009	Me objekt shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Vuno-Metoq”	3587
Kërkesë e MPPTT nr.2036/1, datë 30.4.2009	Me objekt shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë”	3593
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Koli Mike dhe caktimin e kërkueses si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij	3602

VENDIM
Nr. 421, datë 28.4.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKË SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 28 prill 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 9 (nëntë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 30 prill 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 9 (nëntë) automjete dhe 23 (njëzet e tre) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit të Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në partneritetin për paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut, dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.425, datë 4.5.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKË SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në

territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 4 maj 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 9 (nëntë) automjete dhe 27 (njëzet e shtatë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti-Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 6 maj 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 9 (nëntë) automjete dhe 29 (njëzet e nëntë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në partneritetin për paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut, dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.426, datë 22.4.2009

PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË DËRGUAR ME MISIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me INSIG, sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që janë me mision ushtarak jashtë vendit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2009, miratuar për këtë ministri.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe INSIG, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.427, datë 27.4.2009

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1, DATË 7.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PAJISJEN, PËR HERË TË PARË, ME LETËRNJOFTIM TË SHTETASVE SHQIPTARË
DHE PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE E TË MASAVE SHTRËNGUESE PËR ATA, QË NUK
APLIKOJNË BRENDË KËTYRE AFATEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 179 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë“, të neneve 1 e 3, pika 2, të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë” dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- a) në pikën 4, afati “15 prill 2009” bëhet “30 prill 2009”;
- b) Në pikën 4/1, afati “1 prill 2009” bëhet “1 korrik 2009”.

2. Vendimi nr.332, datë 1.4.2009 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.430, datë 22.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË SË PËRHERSHME TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PRANË SELISË SË NATO-S, BRUKSEL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i dytë i pikës 2, shfuqizohet.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Në Përfaqësinë e Përherëshme të Republikës së Shqipërisë pranë selisë së NATO-s funksionon përfaqësia ushtarake, e cila përbëhet nga:

- | | |
|---|-----------------|
| - Përfaqësues ushtarak në NATO | gjeneral major; |
| - Zëvendëspërfaqësues | kolonel; |
| - Oficer shtabi për inteligjencën | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për operacionet e stërvitjen | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për logjistikën | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për planifikimin | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për komunikim/standardizim | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për komitetet politiko-ushtarake të NATO-s dhe koordinimin me BE-në | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për mbrojtjen ajrore | nënkolonel; |
| - Specialist për administrim/financë/protokoll | major; |
| - Nënoficer për administrimin/sekretar/operator | kapter; |
| - Nënoficer për regjistrin, rrjetin e klasifikuar | kapter; |
| - Shofer/adjutant | kapter. |

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.431, datë 27.4.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT
PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 2, e 20, të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 11 të kreut II “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Shtetasit e vendeve të përcaktuara në lidhjen nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të pajisur me vizë “Shengen”, të tipit “C”, për qëndrim afatshkurtër, dhe të tipit “D”, me shumë hyrje/dalje, si dhe me lejeqëndrimi, të lëshuar nga vendet anëtare të “Shengenit”, lejohen të hyjnë, qëndrojnë dhe tranzitojnë në Republikën e Shqipërisë brenda afatit të vlefshmërisë së vizës apo lejes së qëndrimit, pa pasur nevojë të pajisen me vizë nga autoritetet përkatëse shqiptare.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.546, datë 28.5.2009

PËR MIRATIMIN E MASTERPLANIT PËR ZHVILLIMIN E PORTIT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 2, 33, 50 e 51 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për autoritetin portual”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e masterplanit për zhvillimin e portit të Durrësit, sipas studimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, autorizohet që, në zbatim të pikës 10, faqe XXIII, të masterplanit, të negociojë, me shoqërinë “Durrës Kurum Shipping”, sh.a. brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e territorit të kantierit, në administrimin e Autoritetit Portual, Durrës.

3. Territori i kaluar në administrim të Autoritetit Portual, Durrës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të destinohet për shërbime portuale, si terminal çimentoje, kontenierësh ose tragetesh, sipas marrëveshjes, që do të lidhet për këtë qëllim.

4. Në varësi nga zbatimi i pikave 2 e 3 të këtij vendimi, të miratohet alternativa FR 310 e masterplanit, për zhvillimin e portit të Durrësit.

Në rast se brenda afatit të miratuar në këtë vendim nuk plotësohen kushtet për zhvillimin e alternativës FR 310 të masterplanit, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të zhvillojë opsionin rezervë FR 360.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Autoriteti Portual, Durrës, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.274, datë 5.5.2009

PËR “PAJISJEN, PËR HERË TË PARË, ME LETËRNJOFTIM, TË SHTETASVE SHQIPTARË TË MOSHËS MBI 18 VJEÇ DHE PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE E TË MASAVE SHTRËNGUESE, PËR ATA, QË NUK APLIKOJNË BRENDA KËTYRE AFATEVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, si dhe të nenit 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të gjithë shtetasit që janë në moshën mbi 18 vjeç, në datën 28 qershor 2009, dhe nuk disponojnë pasaportë, janë të detyruar të pajisen me letërnjoftim deri më datë 15 maj 2009.

2. Shtetasit e përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi, nëse nuk pajisen me letërnjoftim deri më 15 maj 2009, nuk përfitojnë shërbimet e mëposhtme:

a) Pagesën ose shpërblimet për të gjithë personat fizikë, të punësuar në administratën dhe institucionet publike, si dhe për personat e punësuar në shoqëri, agjenci e ente shtetërore, qendrore apo vendore;

b) Pagesën për ndihmë, përkrahje sociale apo çdo lloj ndihme tjetër, ofruar nga institucionet publike qendrore dhe vendore;

c) Pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit;

d) Shërbimin në zyrat e gjendjes civile, me përjashtim të regjistrimit të akteve të lindjes dhe të vdekjes.

3. Ofrimi i shërbimeve, të parashikuara sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, do të bëhet përkundrejt paraqitjes nga subjektet pranë organit përkatës, në momentin e kërimit të shërbimit, letërnjoftimin ose formularin e aplikimit për letërnjoftim. Në rast se subjekti disponon vetëm formularin e aplikimit për letërnjoftim, dorëzimi i letërnjoftimit duhet të bëhet brenda një afati jo më shumë se dy javë.

4. Të gjithë ofruesit e shërbimeve që nuk zbatojnë kërkesat e këtij udhëzimi, mbajnë përgjegjësi dhe përgjigjen sipas dispozitave të parashikuara në pikën 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për

përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, i ndryshuar.

5. Ngarkohen të gjitha institucionet në varësi të Ministrisë së Brendshme, që ofrojnë shërbimet e përmendura në pikën 2, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

UDHËZIM
Nr.27, datë 27.4 2009

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE MËNYRËS SË PAGESËS SË KOMPENSIMIT TË ÇMIMIT TË LETËRNJOFTIMIT PËR SHITRESAT NË NEVOJË

Në zbatim të nenit 102, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10025, datë 27.11.2008 “Mbi buxhetin e vitit 2009”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 366, datë 15.4.2009 “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim për shitresat në nevojë”, pika 8,

UDHËZOJ:

Kompensimin për çmimin e letërnjoftimit e përfitojnë:

1. Shtetasit e kategorive të përcaktuara në pikën 1 të vendimit nr.366, datë 15.4.2009 që janë mbi 18 vjeç ose që deri në 28 qershor 2009 mbushin 18 vjeç, dhe që nuk disponojnë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit.

2. Shtetasit e kategorive të përcaktuara në pikën 1 të vendimit nr.366, datë 15.4.2009 dhe studentët në institucionet e arsimit të lartë privat, të cilët kanë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit, por kanë aplikuar ose janë pajisur me letërnjoftim deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Parimi bazë i përfitimit nga skemat e kompensimit është ajo e zgjedhjes nga ana e përfituesit, e skemës më të favorshme. Nëse një shtetas përfiton nga dy ose më shumë skema dhe i përdor ato, veprimi konsiderohet kundërvajtje administrative dhe ndiqet nga institucioni përgjegjës, sipas legjisllacionit në fuqi për kundërvajtjet.

Rregullat e hollësishme dhe mënyra e kompensimit të çmimit të letërnjoftimit, sipas kategorive të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.366, datë 15.4.2009, janë si më poshtë:

I. Kompensimi i pagesës për personat me aftësi të kufizuar

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën:

a) 1200 (njëmijë e dyqind) lekë, për të gjithë personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat e verbër dhe pjesëtarët e familjes, në ngarkim të tyre, kur nuk kanë të ardhura;

b) 700 (shtatëqind) lekë për personat me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, në përputhje me pikën 3 të nenit 7 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, si dhe anëtarët e familjes, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar. Personat e kësaj kategorie që trajtohen me pension invaliditeti, përfitojnë sipas pikës 1 germa “b” ose “ç” të vendimit nr.366, datë 15.4.2009.

2. Kompensimi i pagesës bëhet në njësinë e qeverisjes vendore, pranë së cilës ai tërheq pagesën e aftësisë së kufizuar. Bashkitë dhe komunat blejnë, paraprakisht me fondet e tyre në dispozicion ose me të ardhurat e arkëtuara për llogari të tyre, kuponët dhe pajisin me to të gjithë personat e përcaktuar më sipër, kundrejt pagesës së diferencës (vetëm në rastin e pikës 1,b), ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës përkatëse të njohur të kompensimit. Dhënia e kuponit evidentohet në një formular të posaçëm në të cilin regjistrohet emri i përfituesit, numri serial i kuponit, deklarimi që nuk disponon pasaportë

udhëtimi për jashtë shtetit dhe firma e përfituesit.

3. Në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk disponojnë fonde për blerjen e kuponëve, në përputhje me këtë vendim, degët e thesarit lejojnë avancimin e fondeve të tyre të muajve pasardhës deri në plotësimin e shumës së kërkuar, duke njoftuar edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave. Në rast se edhe kjo është e pamundur, njësitë e qeverisjes vendore bëjnë kërkesë për shtesë fondesh në Ministrinë e Financave, e cila i kërkon ministrisë përgjegjëse të akordojë në avancë fondet përkatëse.

4. Personave që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin deri në hyrjen në fuqi të vendimit të sipërcituar, kompensimi u jepet në masën e njohur në muajin pasardhës, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë.

5. Përfituesit e kësaj kategorie, paraqesin në njësitë e qeverisjes vendore një kopje të aplikimit për pajisje me letërnjoftim i bërë deri në datë 20 qershor 2009, për vete dhe secilin anëtar të familjes, ose kopje të letërnjoftimit të marrë brenda datës 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm, çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme dhe mbahet në pagesën e muajit pasardhës .

6. Në fund të çdo muaji, çdo njësi e qeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta listëpagesën, të shoqëruar me fotokopje të aplikimeve dhe të letërnjoftimeve të përfituesve të kompensimit të paguar, për muajin përkatës, për personat që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar.

7. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale bazuar në listëpagesat e marra nga njësitë e qeverisjes vendore, paraqet menjëherë në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde, sipas strukturës buxhetore ku çelet dhe përdoret pagesa e paaftësisë.

8. Ministria e Financave, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, bën çeljen e fondeve për këtë ministri.

9. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pas çeljes së fondeve nga Ministria e Financave bën rimbursimin e tyre për njësitë e qeverisjes vendore, sipas procedurave për çeljen e fondeve buxhetore.

II. Kompensimi i pagesës për personat që vuajnë dënimin ose ndodhen në paraburgim

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën 1200 (njëmijë e dyqind) lekë, për të gjithë personat që vuajnë dënimin ose ndodhen në paraburgim.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve blen dhe pajis me kuponë nëpërmjet institucioneve në varësi të saj, personat e kësaj kategorie me fondet buxhetore të miratuara për sistemin e burgjeve. Dhënia e kuponit evidentohet në një formular të posaçëm në të cilin regjistrohet emri i përfituesit, numri serial i kuponit, deklarimi që nuk disponon pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe firma e përfituesit.

3. Në fund të çdo muaji, kjo drejtori dërgon në Ministrinë e Drejtësisë, listën e personave që kanë aplikuar për letërnjoftim ose kanë marrë letërnjoftimin, së bashku me fotokopjet përkatëse.

4. Ministria e Drejtësisë bazuar në këto lista të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e burgjeve, paraqet menjëherë në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde.

5. Ministria e Financave bazuar në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, bën çeljen e fondeve për këtë ministri, e cila bën rimbursimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas procedurave për çeljen e fondeve buxhetore.

III. Kompensimi i pagesës për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën 1200 (njëmijë e dyqind) lekë, për të gjithë anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian.

2. Për evidentimin e personave të komunitetit rom dhe të komunitetit egjiptian, që nuk trajtohen me ndihmë ekonomike ngrihet, pranë çdo bashkie e komune, një komision verifikimi, i përbërë nga tre persona: një pjesëtar i administratës së ndihmës ekonomike të bashkisë/komunës përkatëse, një person i propozuar nga prefekti dhe një nga këshilli bashkiak/komunal përkatës. Komisioni fton, për evidentimin e personave të këtyre komuniteteve, edhe përfaqësues të vetë komuniteteve.

3. Kompensimi i pagesës bëhet në njësinë e qeverisjes vendore, ku ai është i regjistruar. Për personat e këtyre komuniteteve, të cilët nuk janë të regjistruar, ndiqen paraprakisht procedurat ligjore për regjistrim e më tej trajtohen në njësitë e qeverisjes vendore për pajisjen me letërnjoftim.

4. Bashkitë dhe komunat blejnë paraprakisht me fondet e tyre në dispozicion ose me të ardhurat e arkëtuara për llogari të tyre, kuponët dhe pajisin me to të gjithë personat e përcaktuar më sipër. Dhënia e kuponit evidentohet në një formular të posaçëm në të cilin regjistrohet emri i përfituesit, numri serial i kuponit, deklarimi që nuk disponon pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe firma e përfituesit.

5. Në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk disponojnë fonde për blerjen e kuponëve, në përputhje me këtë vendim, degët e thesarit lejojnë avancimin e fondeve të tyre të muajve pasardhës deri në plotësimin e shumës së kërkuar, duke njoftuar edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave. Në rast se edhe kjo është e pamundur, njësitë e qeverisjes vendore bëjnë kërkesë për shtesë fondesh në Ministrinë e Financave, e cila i kërkon ministrisë përgjegjëse të akordojë në avancë fondet përkatëse.

6. Personave që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin deri në hyrjen në fuqi të vendimit të sipërcituar, kompensimi u jepet në masën e njohur në muajin pasardhës, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë.

7. Përfituesit e kësaj kategorie, paraqesin në njësitë e qeverisjes vendore një kopje të aplikimit për pajisje me letërnjoftim i bërë deri në datën 20 qershor 2009, për vete dhe secilin anëtar të familjes ose kopje të letërnjoftimit të marrë brenda datës 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm dhe çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme. Njësia e pushtetit vendor i shpall debitorë dhe vjelja e detyrimit bëhet sipas procedurave të vjeljes së debitorëve. Gjithashtu njësia e pushtetit vendor nuk i kryen shërbime kësaj kategorie deri në arkëtimin e plotë të shumës përkatëse.

8. Në fund të çdo muaji, çdo njësi e qeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta listëpagesën të shoqëruar me fotokopje të aplikimeve apo të letërnjoftimeve të marra. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, bazuar në listëpagesat e marra nga njësitë e qeverisjes vendore, paraqet menjëherë në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde, sipas strukturës buxhetore.

9. Ministria e Financave, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, bën çeljen e fondeve për këtë ministri.

10. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pas çeljes së fondeve nga Ministria e Financave, bën rimbursimin e tyre për njësitë e qeverisjes vendore, sipas procedurave për çeljen e fondeve buxhetore.

IV. Kompensimi i pagesës për personat që përfitojnë pension

1. Kompensimi i çmimit të letërnjoftimit për pensionistët e gjitha llojeve të pensioneve dhe të personave në ngarkim të tyre, sipas përcaktimit në pikën 1 germa "b" e "ç" të vendimit të sipërcituar dhe të personave mbi 18 vjeç, që marrin pension familjar, kur nuk përfitojnë në skema të tjera kompensuese, kryhet nga zyrat postare të pagesës së pensioneve, të cilat pajisen nga filialet e tyre edhe me kuponët e aplikimit.

2. Për përballimin e efekteve financiare ditore të kompensimit, agjencitë e sigurimeve shoqërore, në ditën e parë të fillimit të zbatimit të vendimit, shtojnë masën ditore të paradhënies për filialet e Postës Shqiptare me 10 për qind. Në ditët në vijim furnizimi me fonde bëhet në atë masë sa janë pagesat e kryera në ditën paraardhëse, sipas listëpagesave të kompensimit, të dorëzuara në organet e sigurimeve shoqërore. Paradhënia do të shuhet deri në datën 20.6.2009, që është edhe afati i fundit i aplikimit.

3. Kompensimin e pagesës për pajisje me letërnjoftim do ta përfitojnë:

Masa e përfitimit	Kategoritë	Rastet e përfitimit
1 000 lekë	<ul style="list-style-type: none"> - Pensionistët me pension mujor qyteti deri në 9 515 lekë - të gjithë pensionistët që marrin pension fshati - pensionistët e qytetit me pension mujor deri në 9515 lekë dhe pensionistët e fshatit 	<ul style="list-style-type: none"> - nuk disponojnë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe aplikojnë në zyrat e gjendjes civile brenda datës 20.6.2009 - nuk disponojnë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe aplikojnë në zyrat e gjendjes civile brenda datës 20.6.2009 - kanë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit, por kanë aplikuar në zyrat e gjendjes civile apo janë pajisur me letërnjoftim deri në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.336, datë 15.4.2009 (rimbursimi bëhet pas datës 1 maj 2009, në ditën që pensionistit i paguhet pensioni)
400 lekë	Pensionistët me pension qyteti mbi 9 515 lekë në muaj	<ul style="list-style-type: none"> - nuk disponojnë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe aplikojnë në zyrat e gjendjes civile brenda datës 20.6.2009 - kanë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit, por kanë aplikuar apo janë pajisur me letërnjoftim deri në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.336, datë 15.4.2009 (rimbursimi pas datë 1 maj 2009 në ditën që pensionistit i paguhet pensioni)

4. Me qëllim që të evidentohen pensionistët që fitojnë të drejtën e kompensimit të çmimit të kuponit të aplikimit, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) dërgojnë në çdo zyrë pagese listat emrore të pensionisteve që nuk disponojnë pasaportë për jashtë shtetit, pasi këta persona, nëse nuk e kanë blerë kuponin e aplikimit, mund ta marrin atë me çmimin e kompensuar dora-dorës. Listat e pensionistëve që nuk disponojnë pasaportë dërgohet në DRSSH nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

5. Rastet e deklaruara dhe konstatuara pa pasaportë, por të paevidentuara në listat paraprake, i njoftohen Institutit të Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet DRSSH-ve, i cili në bashkëpunim me organet kompetente të Ministrisë së Brendshme, pasi i verifikon i autorizon ato për rimbursim. Evidentimi i këtyre personave bëhet në bashkëpunim midis organeve të sigurimeve shoqërore dhe qendrave paguese. Në këtë rast rimbursimi bëhet në muajin pasardhës, por jo më vonë se data 20.6.2009.

6. Përveç listave paraprake që DRSSH-të dërgojnë në qendrat paguese, ku janë të evidentuar të gjithë përfituesit që nuk kanë pasaportë, vetë pensionisti në momentin e përfitimit të kompensimit, plotëson me shkrimin e vet një deklaram, duke shënuar “ jo”, në kolonën përkatëse të listëpagesës që hartohet çdo ditë në qendrën paguese, për shumat e kompensimeve të dhëna.

7. Zyra postare e pagimit të pensionit jep kompensimin për çmimin e kuponit të aplikimit në favor të pensionistit vetëm pas deklaramit të tij dhe vërtetimit të saktësisë së deklaramit, me faktin e të qenit në listat emrore të personave që nuk disponojnë pasaportë, të cilat janë dërguar te ato zyra, nga drejtoritë e sigurimeve shoqërore.

8. Saktësia e këtij deklarami dhe respektimi i informacionit të listave kontrollohet në një kohë të mëvonshme nga auditi i brendshëm duke ballafaquar kompensimet analitike me aplikimet për letërnjoftim ose letërnjoftimet dhe, për rastet e konstatuara si deklaram të pavërteta, do të bëhet ndalesa në pension, duke analizuar edhe përgjegjësitë e personelit.

9. Për çdo procedurë kompensimi si më poshtë vijon, zyrat postare të pagesës së pensioneve do të përpilojnë e plotësojnë listëpagesa të veçanta. Mbi këtë bazë evidentohen tre lloj listëpagesash:

Nr.	Procedurat	Evidentimi	Përmbajtja e listëpagesës
1	Për personat që e kanë marrë letërnjoftimin	Në listëpagesë të veçantë regjistrohet kompensimi në të cilën do të përfshihen të dy llojet (masat) e kompensimeve (1 000 lekë apo 400 lekë). Të dhënat bazë janë të shënuara në letërnjoftimin elektronik.	<ul style="list-style-type: none"> - numrin e pensionit - emrin dhe mbiemrin e pensionistit - numrin personal të identifikimit (e shënuar në krahun e djathtë poshtë të letërnjoftimit elektronik) - datën e lëshimit të letërnjoftimit elektronik - deklaram se nuk ka pasaportë për jashtë shtetit, duke shënuar me shkrimin e tij “jo” - shumën e kompensimit që i paguhet pensionistit - firmën e pensionistit
2	Për personat që kanë aplikuar në zyrat e gjendjes civile	Në listëpagesë të veçantë regjistrohet kompensimi në të cilën do të përfshihen të dy llojet (masat) e kompensimeve (1 000 lekë apo 400 lekë). Të dhënat bazë janë të shënuara në faturën e aplikimit në zyrat e gjendjes civile.	<ul style="list-style-type: none"> - numrin e pensionit - emrin dhe mbiemrin e pensionistit - numrin e kuponit të ngjitur në të majtë të fletës së aplikimit - datën e aplikimit - deklaram se nuk ka pasaportë për jashtë shtetit, duke shënuar me shkrimin e tij “jo” - shumën e kompensimit që i paguhet pensionistit - firmën e pensionistit
3	Për personat që nuk e kanë blerë ende kuponin	Në listëpagesë të veçantë regjistrohet kompensimi në të cilën do të përfshihen të dy llojet (masat) e kompensimeve (1 000 lekë apo 400 lekë).	<ul style="list-style-type: none"> - numrin e pensionit - emrin dhe mbiemrin e pensionistit - numrin e kuponit - deklaram se nuk ka pasaportë për jashtë shtetit, duke shënuar me shkrimin e tij “jo” - shumën e kompensimit që i paguhet pensionistit - firmën e pensionistit

10. Në vijim të pikës 9/3, pensionistët që nuk e kanë blerë ende kuponin dhe nuk kanë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit, do të pajisen me kuponin e aplikimit, duke mbajtur nga shuma e lekëve të pensionit diferencën midis çmimit të kuponit dhe shumës së kompensimit. Në këtë rast (rasti i tretë), pajisja e pensionistit me kupon dhe kompensimi i çmimit të kartës së identitetit bëhet menjëherë nga

qendra pagesë, në datën e tërheqjes së pensionit.

Vleftha e kuponit prej 1200 lekë paguhet:

- nga vetë pensionisti, sipas rastit për 200 ose 800 lekë; dhe
- nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet evidentimit në listëpagesë, të nënshkruar nga pensionisti (si më lart), për 1000 ose 400 lekë.

Në të tri rastet, listëpagesat e veçanta nënshkruhen nga llogaritari dhe arkëtari i qendrës pagesë dhe do të shërbejnë si dokument financiar për vërtetimin e pagesave të kryera dhe rimbursimin e fondeve të shpenzuara.

11. Në fund të çdo dite pune, çdo zyrë pagesë e pensioneve do të raportojë në drejtorinë e filialit totalin e pensionistëve të kompensuar dhe shumën e fondeve të shpenzuara, me qëllim sigurimin dhe shpërndarjen e fondeve për ditën pasardhëse sipas tre rasteve të mësipërme. Filiali, dega e shërbimeve postare do të raportojë brenda orës 16.00 në Drejtorinë e Shërbimeve Financiare në Drejtorinë e Përgjithshme të cilat nga ana e tyre informojnë Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

12. Financimi dhe pagesa e kompensimit të çmimit të letërnjoftimit elektronik, ndjek të njëjtën procedurë, si edhe për pensionet e zakonshme. Zyrat postare do të dorëzojnë çdo ditë në organet përkatëse të sigurimeve shoqërore, listëpagesën origjinale të kompensimit. Format i listëpagesës është si më poshtë :

n/r	Nr. pensionit	emri	mbiemri	nr/kuponit	Disponon pasaportë	Nënshkrimi pensionistit
1	104565	xxxxxx	xxxxxxx	00016518275	jo	ccccccc

13. Shpenzimet për pagesat e kryera nga Posta Shqiptare, për kompensimin e çmimit të kuponit të aplikimit për letërnjoftimin elektronik, të vërtetuar në listëpagesat si më lart, evidentohen në llogarinë « Debitorë të vitit në vazhdim » dhe do të mbyllen me fondet e përcaktuara për këtë qëllim.

14. Ministria e Financave ia akordon fondet ISSH-së, mbi bazën e përmbledhëses së listëpagesave sipas qendrave paguese, e cila paraqitet nga ISSH një herë në muaj dhe konform kërkesave të përcaktuara në pikën 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave.

V. Kompensimi i pagesës për studentët

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën 1000 lekë, për studentët e institucioneve të arsimit të lartë publik. Në këtë kategori përfshihen edhe studentët që ndjekin studimet me kohë të pjesshme, por që janë të papunë.

2. Institucionet e arsimit të lartë publik (fakultetet) blejnë me fondet e tyre në dispozicion (fondet buxhetore dhe të ardhurat e tyre), paraprakisht, kuponët dhe pajisin me to të gjithë studentët, që nuk e kanë kryer aplikimin, kundrejt pagesës së diferencës, ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës së njohur të kompensimit. Studentëve, që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin u jepet kompensimi, në masën e përcaktuar me sipër, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë. Dhënia e kuponit evidentohet në një formular të posaçëm në të cilin regjistrohet emri i përfituesit, numri serial i kuponit, deklarimi që nuk disponon pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe firma e përfituesit.

3. Përfituesit e kësaj kategorie, paraqesin në fakultetin përkatës një kopje të aplikimit për pajisje me letërnjoftimin e bërë deri në datën 20 qershor 2009, ose kopje të letërnjoftimit të marrë brenda datës 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm dhe çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme. Fakulteti i shpall debitorë studentët që nuk kanë plotësuar kushtet e mësipërme dhe vjelja e detyrimit bëhet sipas procedurave të vjeljes së debitorëve.

4. Në fund të çdo muaji, çdo institucion i arsimit të lartë publik dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, listëpagesën të shoqëruar me fotokopje të aplikimeve për letërnjoftim ose kopje të letërnjoftimit të përfituesve të kompensimit të paguar.

5. Studentët e universiteteve jopublike, që kanë aplikuar ose janë pajisur me letërnjoftimin deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, u jepet kompensim në masën e përcaktuar më sipër, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë. Universitetet jopublike hartojnë listëpagesën e përfituesve dhe së bashku me fotokopje të aplikimit për letërnjoftim ose kopje të letërnjoftimit, e dërgojnë në MASH kërkesën për rimbursim

6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës bazuar në listëpagesat e marra nga universitetet publike dhe jopublike menjëherë, paraqet në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde në strukturën buxhetore që përfaqëson buxhetin e arsimit të lartë.

7. Ministria e Financave, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, bën çeljen e fondeve për këtë ministri.

8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës pas çeljes së fondeve nga Ministria e Financave bën rimbursimin për universitetet publike në llogarinë buxhetore pranë degëve të thesarit, për universitetet jopublike në llogaritë e tyre likuiduese pranë bankave të nivelit të dytë.

9. Universitetet jopublike pas marrjes së fondeve nga MASH, rimburojnë të gjithë studentët përfitues, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

VI. Kompensimi i pagesës për anëtarët e familjeve në ndihmë ekonomike

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën 1000 lekë, për çdo anëtar familjeje, që trajtohet me ndihmë ekonomike.

2. Kompensimi i pagesës bëhet në njësinë e qeverisjes vendore, pranë së cilës ai tërheq pagesën e ndihmës ekonomike. Bashkitë dhe komunat blejnë paraprakisht me fondet e tyre në dispozicion ose me të ardhurat e arkëtuara për llogari të tyre, kuponët dhe pajisin me to të gjithë personat e përcaktuar më sipër, kundrejt pagesës së diferencës ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës përkatëse të njohur të kompensimit. Dhënia e kuponit evidentohet në një formular të posaçëm në të cilin regjistrohet emri i përfituesit, numri serial i kuponit, deklarimi që nuk disponon pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe firma e përfituesit.

3. Në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk disponojnë fonde për blerjen e kuponëve, në përputhje me këtë vendim, degët e thesarit lejojnë avancimin e fondeve të tyre të muajve pasardhës deri në plotësimin e shumës së kërkuar, duke njoftuar edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave. Në rast se edhe kjo është e pamundur, njësitë e qeverisjes vendore bëjnë kërkesë për shtesë fondesh në Ministrinë e Financave, e cila i kërkon ministrisë përgjegjëse të akordojë në avancë fondet përkatëse.

4. Personave që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin deri në hyrjen në fuqi të vendimit të sipërcituar, kompensimi u jepet në masën e njohur në muajin pasardhës, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë.

5. Përfituesit e kësaj kategorie, paraqesin në njësitë e qeverisjes vendore një kopje të aplikimit për pajisje me letërnjoftim i bërë deri në datën 20 qershor 2009, për vete dhe secilin anëtar të familjes, ose kopje të letërnjoftimit të marrë brenda datës 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm, çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme dhe mbahet në pagesën e muajit pasardhës.

6. Në fund të çdo muaji, çdo njësi e qeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, listëpagesën të shoqëruar me fotokopje të aplikimeve dhe të letërnjoftimeve të përfituesve të kompensimit të paguar, për muajin përkatës, për personat që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike.

7. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, bazuar në listëpagesat e marra nga njësitë e qeverisjes vendore, paraqet menjëherë në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde, sipas strukturës buxhetore ku çelet dhe përdoret ndihma ekonomike.

8. Ministria e Financave, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, bën çeljen e fondeve për këtë ministri.

9. Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pas çeljes së fondeve nga Ministria e Financave bën rimbursimin e tyre për njësitë e qeverisjes vendore, sipas procedurave për çeljen e fondeve buxhetore.

VII. Kompensimi i pagesës për shtetasit që votojnë për herë të parë, ata që kanë lindur në periudhën 19.2.1989 – 28.6.1991, pavarësisht nga gjendja ekonomike dhe sociale.

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën 1000 lekë për të gjithë shtetasit që votojnë për herë të parë.

2. Drejtoritë arsimore në rrethe blejnë, paraprakisht, kuponët dhe i pajisin me to nxënësit, votues për herë të parë, të shkollave të mesme publike, kundrejt pagesës së diferencës, ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës së njohur të kompensimit. Nxënësve, që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin u jepet kompensimi, në masën e përcaktuar në vendim, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë. Dhënia e kuponit evidentohet në një formular të posaçëm në të cilin regjistrohet emri i përfituesit, numri serial i kuponit, deklarimi që nuk disponon pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe firma e përfituesit.

3. Bashkitë e komunat kryejnë pagesat vetëm për personat e kësaj kategorie, por që nuk janë studentë apo nxënës.

4. Përfituesit e kësaj kategorie, paraqesin në drejtoritë arsimore/ njësitë e qeverisjes vendore një kopje të aplikimit për pajisje me letërnjoftim i bërë deri në datën 20 qershor 2009, ose kopje të letërnjoftimit të marrë brenda datës 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm, çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme dhe ndaj tyre merren masa administrative deri në kthimin e shumës së përfituar.

5. Në fund të çdo muaji, çdo drejtori arsimore/ njësi e qeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës/Ministrinë e Brendshme, listëpagesën të shoqëruar me fotokopje të aplikimeve dhe të letërnjoftimeve të përfituesve të kompensimit të paguar, për muajin përkatës.

6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Ministria e Brendshme, bazuar në listëpagesat e marra nga drejtoritë arsimore dhe njësitë e qeverisjes vendore, paraqesin menjëherë në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde.

7. Ministria e Financave, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës/Ministrisë së Brendshme, bën çeljen e fondeve.

8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Ministria e Brendshme, pas çeljes së fondeve nga Ministria e Financave bën rimbursimin e tyre për DAR/ njësitë e qeverisjes vendore, sipas procedurave për çeljen e fondeve buxhetore.

VIII. Kompensimi i pagesës për personat që përfitojnë pagesë papunësie

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën 700 (shtatëqind) lekë, për çdo person që përfiton pagesë papunësie.

2. Zyrat e punës në rrethe blejnë, paraprakisht, dhe pajisin me kuponë personat e përcaktuar mësipër, kundrejt pagesës së diferencës, ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës së njohur të kompensimit. Personave, që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin, u jepet kompensimin, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë. Dhënia e kuponit evidentohet në një formular të posaçëm në të cilin regjistrohet emri i përfituesit, numri serial i kuponit, deklarimi që nuk disponon pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit dhe firma e përfituesit.

3. Përfituesit e kësaj kategorie, paraqesin në zyrat e punës një kopje të aplikimit për pajisje me letërnjoftim i bërë deri në datën 20 qershorit 2009, ose kopje të letërnjoftimit të marrë brenda datës 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm, çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme dhe mbahet në pagesën e muajit pasardhës.

4. Në fund të çdo muaji, çdo zyrë punësimi dërgon në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, listëpagesën, të shoqëruar me fotokopje të aplikimeve për letërnjoftim ose kopje të letërnjoftimit të marrë të përfituesve të kompensimit të paguar.

5. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, bazuar në listëpagesat e marra nga zyrat e punës, menjëherë paraqet në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde sipas strukturës buxhetore ku çelet dhe përdoret pagesa e papunësisë.

6. Ministria e Financave, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, bën çeljen e fondeve për këtë ministri.

7. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale pas çeljes së fondeve nga Ministria e Financave, bën rimbursimin e tyre për zyrat e punës .

IX. Kompensimi i pagesës për punonjësit e institucioneve buxhetore (të qeverisjes qendrore dhe vendore) dhe personave në ngarkim të tyre pa të ardhura

1. Kompensimi i pagesës për pajisjen me letërnjoftim, bëhet në masën 200 (dyqind) lekë, për çdo punonjës buxhetor me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, dhe për anëtarët e familjeve të tyre në ngarkim, pa të ardhura.

2. Institucionet buxhetore blejnë kuponët dhe pajisin me to punonjësit që nuk kanë pasaportë udhëtimi. Diferenca midis çmimit të kuponit dhe masës së kompensimit i mbahet përfituesit në pagën pasardhëse. Për personat që kanë kryer aplikimin deri në daljen e këtij vendimi, u jepet në pagën pasardhëse kompensimi prej 200 lekësh.

3. Përfituesit e kësaj kategorie, paraqesin në zyrat e financës të punëdhënësit të tyre një kopje të aplikimit për pajisje me letërnjoftim i bërë deri në datën 20 qershor 2009, ose kopje të letërnjoftimit të marrë brenda datës 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm, çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme dhe mbahet në pagesën e muajit pasardhës .

4. Në fund të çdo muaji, çdo njësi shpenzuese dërgon në ministrinë e linjës/institucionin qendror listëpagesën, të shoqëruar me fotokopje të aplikimeve për letërnjoftim e përfituesve të kompensimit të paguar për muajin përkatës.

5. Ministria e linjës/institucioni qendror, bazuar në informacionin e marrë nga njësitë shpenzuese, menjëherë paraqet në Ministrinë e Financave, kërkesat e detajuara për fonde sipas strukturës buxhetore në të cilën paguhen pagat e personelit buxhetor.

6. Ministria e Financave, bazuar në kërkesën e ministrive të linjës, bën çeljen e fondeve për këto ministri.

7. Ministria e linjës, pas çeljes së fondeve nga Ministria e Financave, bën rimbursimin e fondeve për njësitë shpenzuese.

8. E njëta procedurë do të ndiqet edhe për administratën e njërive të pushtetit vendor, si dhe për punonjësit e spitaleve nga ISKSH-ja.

Pas përfundimit të procesit të aplikimit për letërnjoftim dhe përfundimit të pagesave dhe rimbursimit të përfituesve, ministritë e linjës, duhet të dërgojnë në Ministrinë e Financave raportin përfundimtar financiar.

Listëpagesat e shoqëruara me fotokopje të aplikimeve për letërnjoftime ose kopje të letërnjoftimit të marrë, auditohen nga audit i brendshëm i secilit institucion dhe arkivohen, për ruajtje dhe auditim të jashtëm, në ministritë dhe institucionet qendrore respektive.

Udhëzimi nr.25, datë 3.4. 2009, i përbashkët i Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për rregullat dhe mënyrat e kompensimit të pagesës për pajisjen me letërnjoftim për shtresat në nevojë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE

Ridvan Bode

3569

UDHËZIM
Nr.1, datë 14.5.2009

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE TARIFAT E SHPËRBLIMIT
TË PËRKTHYESVE TË JASHTËM PËR PËRKTHIMIN E LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT
EUROPIAN NË SHQIP DHE TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË NJË NGA GJUHËT
ZYRTARE TË BE-SË**

Në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.9800, datë 10.9.2007, e ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007 dhe pikave 1 dhe 9 me vendim të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 7.3.2007 “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit European”, Ministri i Integritimit

UDHËZON:

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për prokurimin e shërbimit të përkthimit të legjislacionit european në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit European (në vijim BE) me qëllim përzgjedhjen e subjekteve të licencuara që mund ta kryejnë këtë shërbim, si dhe tarifave të shpërblimit për këtë shërbim.

2. Përkthimi i legjislacionit të BE-së dhe i legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët zyrtare të BE-së do të kryhet nga përkthyes të jashtëm, të cilët do të përzgjidhen në përputhje me procedurat dhe rregullat e përcaktuara në kuadrin ligjor ekzistues të prokurimit publik edhe në këtë udhëzim.

3. Përkthyesi i jashtëm mund të jetë çdo person fizik ose juridik, i licencuar për të kryer këtë veprimtari në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

4. Numri i përkthyesve do të përcaktohet çdo vit në përputhje me nevojat për përkthim sipas kalendarit të përkthimit të përgatitur nga Ministria e Integritimit.

5. Kriteret teknike dhe profesionale që duhet të plotësojnë kandidatët për përkthyes të jashtëm janë:

Kritere të përgjithshme për subjektin juridik:

- a) të jetë i licencuar për të kryer shërbimin e përkthimit;
- b) të ketë eksperiencë të mëparshme në përkthime në gjuhën për të cilën do të përkthejë;
- c) të ketë kapacitete njerëzore që do të punojnë për përkthimin e materialeve.

Kritere për personelin e subjekteve që do të përfshihen në përkthim:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të mos ketë qenë i dënues apo të mos jetë në ndjekje penale;
- c) të ketë mbaruar arsimin e lartë :
 - i) në ndonjë nga universitetet brenda vendit, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në gjuhën për të cilën aplikon, preferohet me notë mesatare mbi 8;
 - ii) në ndonjë nga universitetet jashtë vendit në gjuhën për të cilën konkurron;
 - iii) në ndonjë nga universitetet brenda vendit, në qoftë se vërtetojnë njohjen e gjuhës përkatëse;
- d) të ketë eksperiencë pune prej jo më pak se dy vjetësh në përkthim;
- e) të zotërojnë shumë mirë programet bazë të kompjuterit;
- f) të ketë aftësi të mira komunikimi.

Kanë përparësi:

- a) përkthyesit që kanë kryer edhe më parë përkthime të *Acquis Communautaire* (ose edhe akteve juridike për llogari të institucioneve të tjera);

b) personat që kanë ndjekur studime të thelluara dhe kanë tituj dhe grada shkencore në gjuhën për të cilën konkurrojnë dhe / ose në fusha specifike të *Acquis Communautaire* ;

c) personat që kanë gjuhë amtare gjuhën të cilën kërkojnë të përkthejnë;

d) personat që përdorin programe profesionale për përkthimin.

5.1 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe këtë udhëzim, përcakton kriteret specifike për përzgjedhjen e përkthyesve me propozim të Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit Europian, të cilat publikohen në ftesën e hapur për shprehje interesi pjesëmarrjeje.

6. Përzgjedhja e subjekteve fituese do të bëhet me dy faza.

6.1 Gjatë fazës së parë të gjithë të punësuarit dhe subjektet e interesuara do t'i nënshtrohen vlerësimit për aftësi profesionale në përkthim, nëpërmjet vlerësimit të dosjes dhe provimit me shkrim.

6.2 Secili nga subjektet fizike dhe juridike do të paraqesë për vlerësimin profesional të gjithë personelin e tij, të cilët do të përkthejnë në emër të subjektit, në rast se ky i fundit përzgjidhet fitues.

6.3 Vlerësimi i aftësive profesionale të përkthimit do të bëhet nga një komision i posaçëm testimi.

6.3.1 Komisioni ka në përbërje të tij 3 anëtarë, ku dy janë pedagogë të gjuhës së huaj për të cilën zhvillohet testimi, si dhe një përfaqësues nga Ministria e Integrimit.

6.3.2 Emërimi dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit të testimit, miratohet nga Ministri i Integrimit.

6.3.3 Në përfundim të testimit, komisioni dorëzon vlerësimin përfundimtar të firmosur nga anëtarët, duke i renditur kandidatët individualisht dhe sipas subjekteve, sipas gjuhës dhe totalit të pikëve të marra. Maksimumi i pikëve është 100 pikë; 30 pikë nga të dhënat profesionale pas vlerësimit të dosjes nga komisioni dhe, 70 pikë nga njohuritë gjuhësore dhe profesionale pas provimit me shkrim. Vendimi i anëtarëve të komisionit merret me shumicë të thjeshtë.

7. Pas paraqitjes së rezultateve të testimit, Ministria e Integrimit, u dërgon subjekteve të përzgjedhura ftesën për ofertë, duke u kërkuar atyre të paraqesin ofertën.

7.1. Vlerësimi i ofertës do të bëhet mbi bazën e kriterit të cilësisë dhe afatit për përmbushjen e shërbimit.

8. Shqyrtimi i ofertës dhe njoftimi i kandidatëve fitues bëhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik.

8.1 Subjektet fituese do të përfshijnë në përkthimin e materialeve vetëm personat e përzgjedhur në fazën e parë të prokurimit. Mosrespektimi i këtij detyrimi çon në përjashtimin e subjektit fitues.

9. Përkthimi i dokumenteve zyrtare shpërblehet për faqe kompjuterike. Faqja kompjuterike përmban 2200 (dy mijë e dyqind) shkronja e shenja duke përfshirë edhe ndarjet e nevojshme të materialit të shkruar në fjalë, kryeradhë, paragrafë, kapituj dhe pjesë. Skicat, fotot, tabelat e skemat që përfshihen në tekstin e përkthyer llogariten e shpërblehen mekanikisht si faqe kompjuterike sipas vendit që zënë në tekst.

10. Tarifa e shpërblimit për subjektet e licencuara për përkthimin e dokumenteve do të përcaktohet në bazë të tarifave të përcaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi.

11. Mënyra, kushtet dhe afatet e realizimit të përkthimit të dokumenteve zyrtare rregullohen shprehimisht në kontratën tip që lidhet midis palëve për përkthimin e dokumenteve zyrtare.

12. Ngarkohet Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në Ministrinë e Integrimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT
Majlinda Bregu

UDHËZIM
Nr.2, datë 14.5.2009

**PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR MIRATIMIN E MATERIALEVE
TË PËRKTHYERA TË LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN NË SHQIP**

Në mbështetje të nenit 118 të kushtetutës, ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, pikave 5 dhe 9 me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7.3.2007 “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Europian”, Ministri i Integritimit

UDHËZON:

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, të cilët do të vlerësojnë dhe miratojnë përkthimin në gjuhën shqipe të legjislacionit europian.

2. Komisioni i posaçëm është komision me karakter *ad hoc*, i cili ngrihet me urdhër të Ministrisë së Integritimit, bazuar në pikën 5 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7. 3. 2007 “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Europian”.

2.1 Ministri i Integritimit në fillim të çdo viti, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit Europian, përcakton komisionet dhe emëron anëtarët e tyre. Në këtë akt do të përcaktohen kapitujt/nënkaptujt e *Acquis Communautaire*, që do të mbulojë një komision, si dhe funksionet përkatëse të secilit prej anëtarëve.

2.2 Çdo komision përbëhet nga:

a) dy ekspertë të Ministrisë së Integritimit me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm;
b) një ekspert i ministrisë së linjës apo institucionit qendror sipas fushave përkatëse të akteve ligjore të shqyrtuara, që caktohet nga këta të fundit me kërkesë të Ministrisë së Integritimit brenda muajit janar; si dhe

c) dy ekspertë të jashtëm që caktohen nga Ministria e Integritimit, me propozim të universiteteve dhe instituteve shkencore e kërkimore ose përzgjidhen individë të shquar të fushës përkatëse.

2.3 Komisioni drejtohet nga njëri prej përfaqësuesve të Ministrisë së Integritimit, i përcaktuar si i tillë në aktin e emërimit.

3. Komisioni ka këto detyra kryesore:

a) shqyrton në tërësi materialet e përkthyer të legjislacionit europian në gjuhën shqipe;
b) kontrollon dhe përmirëson materialet e përkthyer: nga përmbajtja, forma, uniformiteti e terminologjia, në përputhje me standardet e përcaktuara dhe bëra me dije nga Ministria e Integritimit;
c) siguron unifikimin e terminologjisë së përdorur, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria e Integritimit;
ç) përcakton terminologjinë e fushës dhe ia bën me dije Ministrisë së Integritimit.

4. Anëtarët e komisionit nga Ministria e Integritimit, ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

a) të kenë eksperiencë në fushën përkatëse, përbën avantazh njohja e legjislacionit europian në atë fushë;

b) të kenë njohuri shumë të mira të njërës prej gjuhëve zyrtare të BE-së, përbën avantazh njohja e një gjuhe të dytë;

c) të kenë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të punës në grup;

ç) përbëjnë avantazh studimet e thelluara në fushën përkatëse, si dhe pjesëmarrja në grupe pune mbi përafrimin e legjislacionit ose në grupin negociator.

5. Anëtarët e komisionit, si ekspertë të jashtëm, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

a) të kenë eksperiencë në fushën përkatëse, përbën avantazh njohja e legjislacionit europian në fushën përkatëse;

b) të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në fushën përkatëse;

c) të kenë njohuri shumë të mira të njëres prej gjuhëve zyrtare të BE-së, përbën avantazh njohja e një gjuhe të dytë;

ç) të kenë tituj dhe grada shkencore;

d) të kenë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të punës në grup.

6. Komisioni ushtron detyrat e tij brenda periudhës kohore, të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Integrimit.

6.1 Komisioni mblidhet sa herë e shikon të nevojshme brenda periudhës kohore, të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Integrimit.

6.2.1 Drejtuesi i komisionit ka këto funksione kryesore:

a) organizon mbledhjet e komisionit;

b) drejton mbledhjet e komisionit;

c) koordinon punën ndërmjet anëtarëve të komisionit;

d) mban kontakte me Drejtorinë e Përkthimit të Legjislacionit Europian pranë Ministrisë së Integrimit;

e) mban procesverbalin e mbledhjeve.

6.3 Komisioni në mbledhjen e tij të parë vendos për organizimin e punë dhe ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve në përputhje me urdhrin e Ministrit të Integrimit.

7. Vendimi i marrë pasqyrohet në një procesverbal dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.

7.1 Aktet e miratuara nga komisioni, së bashku me procesverbalin përkatës, i dërgohen Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit Europian për rishikimin përfundimtar.

8. Anëtarët e komisionit nga ministrinë e linjës dhe institucioneve të tjera qendrore, si dhe ekspertët e jashtëm, do të shpërblehen për punën e kryer në bazë të numrit të faqeve të shqyrtuara prej tyre.

8.1 Pagesa e anëtarit nga ministrinë e linjës dhe institucioneve të tjera qendrore do të jetë 200 lekë për çdo faqe të shqyrtuar; ndërsa pagesa për ekspertët e jashtëm do të jetë 400 lekë për çdo faqe të shqyrtuar.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT
Majlinda Bregu

VENDIM
Nr.13, datë 4.5.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:			
Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 3.3.2009, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentash çështjen nr.4 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

SUBJEKTI I INTERESUAR: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 06.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, germa “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, pasi shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe e bisedoi atë në tërësi,

VËREN:

I

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka nisur procedimin penal ndaj të pandehurit K.P., duke e akuzuar për veprën penale “kundërshtim të punonjësve të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal. I pandehuri është babai i dy djemve, të cilët kanë refuzuar kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Për këtë arsye, punonjësit e policisë kanë kryer shoqërimin me forcë të dy djemve, që i kanë gjetur në banesën e tyre, për te qendra e rekrutim-mobilizimit. Po kështu, ata kanë shoqëruar dhe të pandehurin me pretendimin se ai i kishte kundërshtuar me forcë.

Me vendimin datë 21.04.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e akteve Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 06.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë nen parashikohet se: *“Organet e Policisë së Shtetit në qarqe detyrohen të shoqërojnë nëpër qendrat e rekrutim-mobilizimit të qarkut shtetasit të cilët janë thirrur për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas listëthirrjeve të dërguara nga QRM dhe që nuk janë paraqitur në qendrën e rekrutim-mobilizimit. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Brendshëm nxjerrin udhëzim të përbashkët për zbatimin e këtij neni”.*

Kërkuesi, për shfuqizimin e nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 6.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, ka parashtruar këto shkaqe:

- ky nen bie ndesh me frymën dhe parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe me nenet 17/2, 27/2, 37 të Kushtetutës;

- sipas paragrafit 2 të nenit 17/2 të Kushtetutës, kufizimi i lirisë dhe i të drejtave për interes publik nuk mund të cenohet thelbin e tyre dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Mënyra se si është formuluar neni 36/1 i ligjit për shërbimin ushtarak u lë dorë të lirë organeve të policisë të ushtrojnë kontrolle banese në çdo kohë dhe të shoqërojnë rekrutët dhe familjarët e tyre, duke i mbajtur në komisariate pa kufizim. Kjo dispozitë është një tejkalim i kufizimeve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, pasi i hap rrugë arbitraritetit të organeve policore.

Kuvendi i Shqipërisë, si palë e interesuar, ka pretenduar se sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, duhet të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë mes ligjit, objekt kërkese, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

Në rastin konkret, Gjykata nuk pengohet nga verifikimi i kushtetutshmërisë së nenit në fjalë për të zgjidhur me themel çështjen, pasi kontrolli kushtetues i dispozitës së ligjit, objekt i kërkesës, nuk do të ndikonte në “fatin” e procedimit penal, sepse kundërshtimi i punonjësit të policisë gjatë përmbyshjes së detyrës së tij në bazë të një ligji, nuk mund të legjitimohet si veprim i justifikueshëm nga pikëpamja ligjore. Kundërshtimi që i ka bërë i pandehuri policisë, do të kishte justifikim vetëm në raste kur policia vepron në kundërshtim me ligjin në fuqi.

II

Kërkuesi ka parashtruar se paragrafi i parë i nenit 36/1 i ligjit nr.9487, datë 6.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” është antikushtetues.

Neni 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u njehtë drejtën gjyqtarëve, që në çdo fazë të gjykimit, kur ato çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve, që për inicues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka pranuar se ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetutshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata dhe zgjidhjes së çështjes konkrete (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.15, datë 7.04.2000*).

Para marrjes së vendimit të pezullimit, gjyqtari apo gjykata duhet të konkludojnë se gjykimi që ata kanë nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra, gjyqtari apo gjykata duhet të çmojnë se ligji që vlerësojnë si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërt, nëse gjyqtari çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas tij vlerësohet si antikushtetues, ai duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes. Në mënyrë që të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata kërkuese, në kuptimin që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë, kur mënyra e zgjidhjes së çështjes konkrete, që është në shqyrtim nga gjykata, do të varet nga vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit. Nuk do të ekzistonte lidhja e drejtpërdrejtë nëse kushtetutshmëria apo jo e çështjes nuk do të sillte dhe ndryshime për pasojat e mundshme të çështjes. Parë në këtë aspekt, gjykata apo gjyqtari është i

kushtëzuar në dërgimin e çështjes në Gjykatë Kushtetuese nga kriteri procedural “lidhje e drejtpërdrejtë”, përcaktuar nga neni 68 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

Në çështjen e paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, kërkuesi nuk e ka vlerësuar siç duhet këtë kriter të rëndësishëm, pasi për rastin në shqyrtim, kjo lidhje nuk është e evidente, sepse i pandehuri është akuzuar për veprën penale “kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit”, akuzë që kërkuesi duhet ta shqyrtojë mbi bazën e verifikimit të elementeve të kësaj figure të veprës penale, sanksionuar nga neni 236 i Kodit Penal. Nëse do të kërkohej antikushtetutshmëria e kësaj dispozite, atëherë mund të thuhej se mund të ekzistonte lidhje e drejtpërdrejtë mes ligjit, për të cilin kërkohet antikushtetutshmëria, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 6.02.2008*). Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë edhe për arsyen se në cilësinë e të pandehurit ka qenë babai i dy djemve, të cilët ishin subjekte të ligjit nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

Pra, në rastin konkret, kërkuesi nuk pengohet nga verifikimi i kushtetutshmërisë së nenit në fjalë, për të zgjidhur me themel çështjen, pasi edhe nëse hipotetikisht do të shpallej antikushtetuese dispozita e ligjit, objekt i kërkesës, kjo nuk do të pengonte për një vendim lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Në asnjë rast kundërshtimi i punonjësit të policisë, gjatë përmbushjes së detyrës së tij në bazë të një ligji, nuk mund të konsiderohet si veprim i justifikueshëm nga pikëpamja ligjore.

Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese e konsideron si të padrejtë pretendimin e kërkuesit, sepse nuk ekziston lidhja e drejtpërdrejtë mes nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 06.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

Sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (Kryetar) Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Fehmi Abdiu, Admir Thanza

VENDIM

Nr.820, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV FRAHOLLI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik, z.Abidin Fraholli, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në komunën Çërravë, Pogradec.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Mesila Doda (Demi)**

VENDIM

Nr.821, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV FLAVIO CABLE”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik, znj.Xhevrie Koçi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në rrethin e Peshkopisë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Mesila Doda (Demi)**

3577

VENDIM
Nr.822, datë 24.4.2009
PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV MAQALLARA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizionë“, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizionë të transmetimeve me kabëll“, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë Maqellara sh.p.k. duke e autorizuar të funksionojë si operator televizion privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në qytetin e Peshkopisë, komuna Maqellarë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.823, datë 24.4.2009
PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV TËRBUF”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizionë“, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizionë të transmetimeve me kabëll“, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik, znj. Shpresa Boriçi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televizion privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në komunat Tërbuf-Dushk.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.824, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV DUSHK”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik, z.Shpëtim Bega, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në komunën Dushk.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.825, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV FUTURA-COM”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë, “FUTURA-COM” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në bashkinë Vlorë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.827, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “K 8”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë“, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë “TV 11” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në bashkinë Sarandë, Vlorë, komunën Golem (Kavajë) komunën Farkë dhe Kashar (Tiranë).
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.828, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV LUNA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik, z.Ardian Dardha, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në qytetin e Kavajës, komuna Luz i Vogël.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.829, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV JUG”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë “INTEL MEDIA” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në qytetin e Fierit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.830, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV PORTËZ”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Halim Kalivaçi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, në fushën e transmetimeve kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në komunën Portëz, qyteti Fier.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.831, datë 24.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV POJAN”

